RREGULLORE FINANCIARE E LPSH

1. Parimet e funksionimimit financiar të LPSH-së janë përcaktuar në Nenin 1, pika 1.4 dhe 1.5 të statutit të LPSH-së.

2. Vendimet më të rëndësishme financiare merren nga Kuvendi i Anëtarëve, ndërsa ndërmjet dy kuvendeve nga Bordi Drejtues dhe Kryetari i LPSH-së, sipas pikave përkatëse statutore: Neni 5, pika 1; Neni 7, pika 1; Neni 10 dhe Neni 14 .

3. Kontrolli i brendshëm financiar i shoqatës bëhet nga Këshilli Mbikqyrës sipas Nenit 8, pika 2 të statutit.

4. Burimet financiare të organizatës përcaktohen në statut sipas Nenit 10.

5. Marëdhëniet kontraktuale të punësimit me pagesë për zyrtarë apo nënpunës sipas nevojave të shoqatës përcaktohen sipas Nenit 9 të statutit.

6. Vendimet mbi aktivitetet e gjetjes së fondeve, lidhjet e marrëveshjeve për sponsorizime apo kontraktuale, shpërndarja e fondeve apo çdo lloj transaksioni tjetër financiare midis shoqatës dhe palëve të tjera, merren nga Bordi Drejtues, në emër të të cilit nënshkruan Kryetari.

7. LPSH ka dy thesaristë, përkatësisht një nga Shqipëria dhe një nga Kosova, si dhe mban të hapura dy llogari bankare një në Kosovë dhe një në Shqipëri. Thesaristët zgjidhen nga Bordi Drejtues në mbledhjen e konstituive të tij.

8. Thesaristët janë përgjegjës për mbarëvajtjen financiare të shoqatës dhe i përgjigjen drejtpërsëdrejti forumeve drejtuese të saj: Kryetarit, Bordit Drejtues dhe Kuvendit të Anëtarëve.

9. Detyrat e thesaristëve janë:
   a) të arkivojnë çdo transaksion financiar;

   b) të administrojnë xhirollogarinë e shoqatës;

   c) të mbledhin dhe regjistrojnë pagesat e kuotizacioneve nga anëtarësia;

   d) të përpilojnë listat me personat që nuk paguajnë kuotat dhe të informojnë forumet drejtuese;

   e) tu shpërndajnë sponsorve potencialë informacion për aktivitetet e shoqatës dhe formularët e sponsorizimit;

   f) të informojnë Kryetarin apo Bordin Drejtues për sponsorë potencialë të aktiviteteve;

   g) të depozitojnë çdo kontratë apo marrëveshje sponsorizimi;

   h) të depozitojnë çdo dokument pronësie të luajtshme apo të paluajtshme të shoqatës;

   i) të përpilojnë raportin financiar vjetor dhe tre vjeçar;

   j) të raportojnë para Bordit Drejtues dhe Këshillit Mbikqyrës sa herë që e kërkojnë një gjë të tillë;

   k) ti venë në dispozicion çdo dokument financiar të shoqatës Këshillit Mbikqyrës dhe auditit të brendshem, sa herë që e kërkojnë një gjë të tillë;

   l) të bashkëpunojë me auditorët e brendshëm apo të jashtëm;

   m) të depozitojnë kontratat për nëpunësit me pagesë të shoqatës sipas vendimeve të Bordit Drejtues;

n) të kryejnë pagesat e rregullta për shërbime apo nëpunësit me pagesë të shoqatës sipas vendimeve të Bordit Drejtues;

o) të informojnë forumet drejtuese për çdo shpërdorim të pronës së shoqatës;

p) të dorëzojnë, nëse i mbaron ose i ndërpritet mandati, te pasardhësi të gjithë arkivin e shoqatës që disponjnë dhe të nënshkruajnë me pasardhësin një procesverbal për gjendjen financiare që dorëzon.

10. Të gjitha sponsorizimet për aktivitetet e shoqatës bëhen duke iu përmbajtur rregullores përkatëse për sponsorizimet. Të gjitha marrëveshjet financiare midis shoqatës dhe individëve apo enteve quhen të vlefshme vetëm nëse janë ratifikuar në Bordin Drejtues.

11. Asnjë drejtues apo anëtar i shoqatës nuk mban përgjegjësi individuale për marrëveshjet financiare të bëra në emër të shoqatës.

12. Çdo raportim financiar periodik (vjetor, trevjeçar) apo joperiodik (auditim, kuvend apo mbledhje e BD e jashtëzakonshme) arkivohet pas miratimit nga forumi që e ka marrë në shqyrtim.

13. Raportimi financiar përmban:
    a) një tabelë kryesore të hyrje-daljeve financiare për periudhën në të cilën ai shtrihet;
    b) një tabelë të veçantë të sponsorizimeve apo dhurimeve;
    c) një tabelë të veçantë të kuotave të anëtarësisë;
    d) një tabelë të veçantë për shpenzimet e aktiviteteve;
    e) një tabelë të veçantë për pagesat.

14. Në rast se ka shpërdorime financiare të shoqatës, të konfirmuara nga një raport auditimi të brendshëm, atëhere Kryetari dhe BD duhet të marrin vendimet përkatëse për procedurën e kompensimit të dëmit ose të deponojnë një padi konform legjislacionit të Shqipërsisë apo Kosovës.